



Ndërmarrja Publike Lokale "Higjiena" Sh.A. Deçan, duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik, shpallë:

KONKURS

Për këtë pozitë të punës:

1. Të shpallet konkurs publik për këtë vend të lir:

- **Titulli i vendit të punës:** Asistent/e i/e Bordit të Drejtorëve;
- **Numri i pozitave:** Një (1).

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar/ me mundësi vazhdimi. Puna provuese gjashtë (6) muaj, në pajtim me Ligjin e Punës.

Përgatitja profesionale/ shkollore: Shkolla e Mesme, preferohet Fakulteti.

Përvoj pune: Së paku 1 vit përvoj pune.

Nën përgjegjësinë e: Bordit të Drejtorëve.

Kushtet e veçanta:

- njohja e punës me kompjuter.
- të ketë aftësi organizative.
- preferohet të ketë trajnime shtesë në komunikimin me publikun.
- njohja e gjuhëve zyrtare dhe preferohet njohja e gjuhës angleze.
- të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime.

Përshkrimi i detyrave të punës dhe përgjegjësitë:

- Merret me organizimin e takimeve të Bordit duke përfshirë përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
- Mban procesverbalet e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve, i shënon ato në librin e Protokollit dhe shpërndan procesverbalet tek drejtorët;
- Merret me çështje tjera të qeverisjes korporatave sipas nevojës;
- Kryen edhe pune tjera sipas direktivave të Bordit të Drejtorëve;

- Për punën e tij/saj i përgjigjet Bordit të Drejtorëve;
- Vendimin për emërim dhe shkarkim e bënë Bordi i Drejtorëve

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Kopjen e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Kopjen e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;
- Kopjen e dëshmisë së përvojës së punës;
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj);
- Certifikata e Mjekut, pas përzgjedhjes nga komisioni.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë Punëtorët e Ndermarrjes që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Pas përfundimit të afatit për aplikim, do të bëhet shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikacioneve dhe do të ftohen për intervistë vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet sipas konkursit.
- *Afati për dorëzimin e aplikacionit është nga data: 06.11.2024 deri më 26.11.2024, në Adresën: Objekti i Administratës së NPL "Higjiena" Sh.A. Rruga "Bjeshkët e Deçanit", 51000, Deçan – Kosovë.*

